



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:260043  
Datë: 26.09.2024  
Numri i dokumentit: 06216175

**AC-I-24-0422**

***Në ankesën e***

***Paditësi/Ankuesi***

**S K** Prishtinë, i përfaqësuar nga M Sh avokat nga Prishtina.

**kundër**

**E paditura**

**NSH KB "Liria"**, (në likuidim), Bardhosh e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. " Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr. sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-2088 të datës 16 maj 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 26 shtator 2024, lëshon këtë:

## **A K T V E N D I M**

**1. Ankesa e paditësit është e bazuar.**

- 2. Anulohet Aktgjykimi shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-2088 të datës 16 maj 2024.**
- 3. Lënda kthehet në Shkallën e Parë të DHPGJS, tek gjyqtari përkatës.**
- 4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

### **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 08 tetor 2013, paditësi përmes postës e dërgoi një ankesë në DHPGJS kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN144-0066 të datës 27 gusht 2013, me të cilën është refuzuar si e pavlefshme, kërkesa për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën prej 01 gusht 2007 e deri me 16 janar 2009 në shumë prej 7,650.00 €, nga NSH "KB Liria" Bardhosh (nëlikuidim), me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Në ankesë paditësi e ka kundërshtuar vendimin e AL duke kërkuar që të ndryshohet ky vendim dhe t'i aprovohet kërkesa për paga për periudhën dhe shumën e cekur. Paditësi e kundërshton konstatimin e AL se kërkesa është parashkruar. Bashkë me ankesë paditësi ka dorëzuar vendimin e ankimuar të AL, një ankesë të dorëzuar në AKP me datë 19 shkurt 2009, formularin e kërkesës të dorëzuar tek AL, një qarkullim për llogarinë e tij bankare në BPB, dhe kopjen e Librezës së punës të mbyllur me 16 janar 2009.

Me datë 13 qershor 2014, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe ka zbatuar drejtë dispozitat materiale. Tutje AKP-ja pohon se në këtë lëndë objekt shqyrtimi është vetëm ligjshmëria e vendimit të AL, duke pohuar se paditësi ka dështuar të tregoj se cili nen i Ligjit të AKP-së është shkelur me vendimin e ankimuar të AL. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja e përsërit pretendimin se kërkesa e paditësit për paga për periudhën 01 gusht 2007 deri 16 janar 2009 në shumë prej 7,650.00 € është parashkruar në bazë të nenit 608 të LPB. Në këtë parastresë ka kërkuar që të refuzohet ankesa dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i AL.

Me datë 15 gusht 2014, paditësi e dorëzon një parashtresë në DHPGJS dhe përgjigjet në mbrojtjen në ankesë. Në këtë parashtresë paditësi i përsërit pretendimet e veta të cekura në ankesë. Bashkë me këtë parashtresë paditësi e dërgon autorizimin për avokatin M Sh.

Me datë 07 nëntor 2014, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS kundërpërgjigjen, në të cilën ajo i përsërit pretendimet e veta të cekura në mbrojtjen në ankesë.

Me datë 16 maj 2024, Shkalla e Parë e DHPGJS me aktgjykimin C-IV-13-2088 ankesën e paditësit e refuzon si ta pabazuar dhe e vërteton vendimin e ankimuar të AL si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e Parë e DHPGJS ka arsyetuar, Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton se njëra ndër çështjet thelbësore kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit, që si e tillë është çështje e rregulluar me dispozita ligjore dhe meqenëse gjykata konstaton se është parashkruar e drejta për të kërkuar në rrugë gjyqësore përmbushjen e detyrimit, pretendimet e tjera të palëve nuk do të shqyrtohen. Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në, parasheh: *kërkesat që konsiderohen të jenë të pasafatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi*; Gjykata gjen se neni 608 i ligjit për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76) në të cilin ishte mbështetur vendimi refuzues i AKP-së ishte shfuqizuar me Ligjin mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Ndërmarrjet (GZ 40/89) i cili ligj kishte hyrë në fuqi me 15 korrik 1989, konkretisht me nenin 74, i cili nen e plotëson Ligjin mbi Ndërmarrjet (GZ 77/88, (i cili kishte hyrë në fuqi me 01 janar 1989), konkretisht nenin 196 i cili qartësisht normon shfuqizimin e të gjitha dispozitave të Ligjit mbi Punën e Bashkuar, përveç dispozitave nga Kreu IV dhe Kreu i VI kaptina 2, dispozita e nenit 608 është e vendosur në Kreun e VI në kaptinën e 3, që do të thotë se është shfuqizuar me këtë ndryshim plotësim të ligjit. Ligji mbi Marrëdhënien e Punës i datës 14 prill 1989 dhe Ligji për të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës i datës 28 shtator 1989, nuk kanë paraparë dispozita të veçanta lidhur me parashkrimin e kërkesave monetare që lindin nga marrëdhënia e punës, megjithatë

kjo nuk do të thotë se instituti i parashkrimit për kërkesat monetare ka mbetur i pa mbuluar me dispozita të tjera ligjore. Gjykata vlerëson se, për kohën kur pretendohet se është krijuar detyrimi, duhet të aplikohet parashkrimi i përgjithshëm për detyrimet civile. Këto rregulla gjinden në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr. 690 të datës 30 mars 1978, të njëjtat rregulla gjinden edhe në Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i cili ka hyrë në fuqi më 19 dhjetor 2012. Në pajtim me nenin 372, paragrafi 1 i LMD-së, parashkrimi i kërkesave periodike siç është paga, është tri (3) vjet; Ligji i ri ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vitesh (neni 353, paragrafi 1, i LMD-së). Po ashtu, Ligji i Punës nr. 03/L-212 i cili është në fuqi, nuk parasheh dispozitë të veçantë për parashkrimin në lidhje me pagesat e të ardhurave, por parasheh një afat të përgjithshëm prej 3 viteve të parashkrimit, në lidhje me kërkesat që lindin nga marrëdhënia e punës. Nga dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se parashkrimi si institut i së drejtës civile në përgjithësi dhe në veçanti afati 3 vjeçar i parashkrimit për kërkesat monetare, është ruajtur në të gjitha ligjet që kanë qenë të aplikuara në atë kohë, por edhe në ligjet që tani janë në fuqi. Prandaj, shihet se parashkrimi për kompensim për paga të papaguara, për periudhën kohore nga 01 gusht 2007, deri me 16 janar 2009, në shumë prej 7,650.00 Euro, të kërkuara në këtë lëndë, ishte i rregulluar me LMD-në (1978), i cili ishte ligj ende në fuqi në atë kohë. Vetëm në dhjetor 2012 ligji i aplikueshëm ndryshoi, por edhe LMD tani në fuqi ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vjetësh. Me vjetërsim/parashkrim, ligjërisht shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër. Në rastin konkret, e drejta për të kërkuar kompensimin e pretenduar për paga të papaguara, është ligjërisht e vjetërsuar pas 3 viteve, pasi që NSH-ja nuk ka përmbushur detyrimin e saj ndaj parashtruesit të kërkesës brenda këtij afati dhe pasi që ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka paraqitur kërkesë në ndonjë procedurë gjyqësore, apo para ndonjë autoriteti kompetent brenda afatit 3 vjeçar, për të kërkuar borxhin e pretenduar në lidhje me kompensimin për paga të papaguara dhe kështu për ta ndaluar rrjedhjen e afatit të parashkrimit. Nga shkresat e lëndës rrjedh se ankuesi kërkesën për kompensimin e pretenduar për një vendim, e ka parashtruar pranë Autoritetit të Likuidimit më 15 korrik 2013,

brenda afatit për parashtrimin e kërkesave pranë AL-së, por që në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura, një kërkesë e tillë në atë kohë vetëm se ishte parashkuar. Ankuesi ka pasur të drejtë të kërkoj përmbushjen e detyrimit të pretenduar pasi që i ka lindur e drejta e kërkesës, kështu që afati i parashkrimit ka rrjedhur nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Ankuesi, me parashtrimin e ankesës kundër vendimit të AL-së, nuk ka pohuar ndonjë fakt apo argument ligjor që do të bënin ndryshimin e rrethanave faktike, sa i përket parashkrimit të së drejtës për të kërkuar në rrugë gjyqësore kompensimin e pretenduar dhe kështu për të ndikuar në ndryshimin e vendimit të ankimuar.

Me datë 29 maj 2024, paditësi përmes postës e ka dërguar në DHPGJS një ankesë kundër aktgjykimit të Shkallës së Parë të DHPGJS C-IV-13-2088 të datës 16 maj 2024, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet padia për paga si e bazuar, ose të priset aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rigjykim. Për më tepër në ankesë, paditësi ka pohuar se komplet dosja e tij gjendet tek AKP-ja dhe përmes provave pa mëdyshje provohet e drejta e tij në kompensimin e pagave të papaguara e të cilat prova nuk janë vlerësuar drejtë as nga AL e as nga Shkalla e Parë e DHPGJS. Tutje, paditësi konsideron se me refuzimin e kërkesës i është shkelur një e drejtë e garantuar me kushtetutë të Republikës së Kosovës dhe me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Tutje paditësi pohon se atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës me datë 16 janar 2009 në ditën kur është privatizuar ndërmarrja dhe se NSH-ja i ka mbetur borxh për pagat e periudhës nga 01 gusht 2007 e deri 16 janar 2009 në shumë prej 7,650.00 €. Paditësi pohon se me kërkesë që të paguhen pagat i është kërkuar edhe AKP-së e cila ishte dorëzuar me 23.01.2009. Paditësi konsideron se për shkak të gabuar të gjendjes faktike gabimisht është zbatuar edhe e drejta materiale. Bashkë me ankesë ai ka dorëzuar: Njoftimin e AKP-së për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 23 janar 2009, një ankesë për shkak të pushimit nga puna të dorëzuar në AKP me datë 19 shkurt 2009, një qarkullim për llogarinë e tij bankare të BPB si dhe kopjen e Librezës së punës e mbyllur me 16 janar 2009.

Me datë 04 korrik 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë përgjigjen në ankesë në të cilën ajo i kundërshton pretendimet ankimore dhe e mbështet Aktgjykimin e ankimuar. Në këtë parashtrësë AKP-ja pohon se ajo i ka paraqitur argumentet e saj në mbrojtjen në ankesë, andaj përsëritja e tyre do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. Nga këto arsye AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të anulohet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit e datës 15 korrik 2013, për kompensim të pagave të papaguara nga NSH KB "Liria" Bardhosh (në likuidim) për periudhën 01 gusht 2007 e deri 16 janar 2009 në shumë prej 7,650.00 €, me vendimin e ankimuar të AL refuzohet si e pavlefshme me arsyetimin se kërkesa për paga është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar.

Kolegji i Apelit vëren se Shkalla e Parë e DHPGJS për të njëjtën bazë ligjore e refuzon ankesën e paditësit dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij në shkallën e parë, si dëshmi ka dorëzuar: vendimin e ankimuar të AL, një ankesë të dorëzuar në AKP me datë 19

shkurt 2009, formularin e kërkesës të dorëzuar tek AL, një qarkullim për llogarinë e tij bankare në BPB dhe kopjen e librezës së punës të mbyllur me 16 janar 2009.

Me ankesën në Shkallën e Dytë, përveç dëshmive të cekura, paditësi ka dorëzuar edhe Njoftimin e AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 16 janar 2009, në ditën kur NSH-ja është privatizuar.

Në bazë të provave të dorëzuara në të dyja shkallët gjyqësore, vërehet se kërkesa e paditësit për pagat e kërkuara për periudhën 01 gusht 2007 e deri 16 janar 2009 në shumë prej 7,650.00 €, nuk është parashkruar siç konstaton gabimisht Autoriteti i Likuidimit dhe Shkalla e Parë e DHPGJS-së.

Paditësi me ankesën e tij në shkallën e dytë e sjell njoftimin e AKP-së për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, e cila provë në bazë të Nenit 70 të LDHP-së në interesin e drejtësisë pranohet nga Kolegji i Apelit.

Siç është konstatuar në shumë raste të mbyllura në jurisprudencën e Kolegjit të Apelit, njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës e ndërpre në parashkrimin e kërkesës, gjë që në këtë rast ky njoftim e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës për paga.

Në këtë lëndë, nuk ka ndonjë provë se cila ishte lartësia e pagës mujore të paditësit për periudhën e cekur dhe një provë e tillë nuk është dërguar as nga paditësi dhe as nuk është kërkuar nga shkalla e parë. Paditësi ka sjellë një qarkullim për llogarinë e tij bankare në BPB, por e cila provë nuk vërteton lartësinë e pagës mujore të paditësit dhe një provë të tillë Kolegji i Apelit nuk ka mund t'ia falë besimin.

Në këtë lëndë, duhet të sigurohet sa ishte lartësia e pagës mujore e paditësit për periudhën e cekur gjë që kjo provë mungon deri në këtë fazë të procedurës.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit e ka aprovuar ankesën e paditësit si të bazuar, e ka anuluar aktgjykimin e ankimuar, dhe e ka kthyer lëndën në rigjykim, për ti dhënë një mundësi paditësit të sjellë prova mbi lartësinë e pagës së tij mujore.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, me datë 15 qershor 2024, në shumë prej 30 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 26 shtator 2024

Msc. Sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues \_\_\_\_\_